

VENDIM
Nr.53, datë 13.11.1997

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Rustem Gjata,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese ,
Hilmi Dakli,	Anëtar i ""
Manol Konomi,	Anëtar i ""
Veli Budo,	Anëtar i ""
Franc Jakova ,	Anëtar i ""
Alfred Karamuço,	Anëtar i ""
Ha1il Kopani,	Anëtar i ""
Kristofor Peçi,	Anëtar i ""
Zija Vuci,	Anëtar i ""

me sekretare Drita Filto, më datë 28.10.1997 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.51 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: VEHBI ALIMUCAJ, presidenti shoqërisë "Vefa Holding" Sh.P.K., përfaqësuar nga avokat Shefqet Muçi.

SUBJEKT I INTERESUAR: KËSHILLI I MINISTRAVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga Thimjo Kondi, Ministër i Drejtësisë.

O B J E K T I:

Shfuqizimi si antikushtetues i nenit 7 të ligjit nr.8227, datë 30.7.1997 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8215, datë 9.5.1997 "Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë".

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji përfaqësuesin e kërkuarit dhe të subjektit të interesuar dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Kërkuarisi ka parashtruar se neni 7 i ligjit nr.8227, datë 30.7.1997 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8215, datë 09.05.1997 "Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë", i jep administratorit të subjektit të kontrollit ose personit të lidhur me ta kompetenca shumë të gjera, duke e vënë në pozitë të pronarit të një pasurie që efektivisht nuk është e tij dhe e zhvesh pronarin e vërtetë nga prona e tij. Sipas kërkuarit një rregullim i tillë ligjor vjen në kundërshtim me parimet kushtetuese që kanë të bëjnë me sanksionimin e iniciativës së lirë e veprimtarisë private të pavarur dhe mbrojtjen e pronës, të parashikuara nga nenet 10 e 11 të ligjit nr.7491, datë 29.04.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" dhe neni 27 të Ligjit kushtetues nr.7692, datë 31.03.1993, kreu "Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut".

Në nenin 7 të ligjit nr.8227, datë 30.07.1997 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8215, datë 09.05.1997 "Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë", janë parashikuar të drejtat e administratorit që nga pezullimi i detyrimeve kontraktore, marrja e drejtimit të veprimtarisë dhe të pasurisë së subjektit të kontrollit në mënyrën që e shikon të nevojshme, ushtrimi i të drejtave të aksionerit, ortakut si dhe personelit administrativ të tyre e deri te e drejta e shitjes dhe e disponimit të veprimtarisë apo të pasurive që administratori e shikon të arsyeshme.

Dhënia e këtyre kompetencave administratorit çon në zhveshjen e personit juridik jobankar jo vetëm nga e drejta e administrimit, por edhe nga të gjitha tagrat e pronësisë.

Gjykata çmon se roli rregullues i shtetit në zhvillimin ekonomik të vendit, ndërhyrja e tij në pronën private për të mbrojtur interesa shoqërore, parim ky i sanksionuar në nenin 10 të ligjit "Për dispozitat kryesore kushtetuese", nuk i japin të drejtë atij të ndërhyjë deri në atë shkallë sa ta zhveshë pronarin nga prona.

Në këto kushte preket edhe parimi i mbrojtjes së barabartë të të gjitha llojeve të pronësisë, i sanksionuar në nenin 11 të ligjit "Për dispozitat kryesore kushtetuese".

Gjykata, gjithashtu vëren se paragrafi i parë i nenit 7 i jep administratorit, si përfaqësues i pushtetit ekzekutiv, të drejta që i përkasin vetëm pushtetit gjyqësor si pezullimi i pagimit të detyrimeve, moszbatimi i kushteve të parashikuara në kontratë apo marrëveshje të lidhura nga subjekti i kontrollit. Në këtë mënyrë çënohet parimi kushtetues i ndarjes së pushteteve, i parashikuar nga neni 3 i ligjit "Për dispozitat kryesore kushtetuese".

Në këto rrethana, Gjykata arrin në përfundimin se neni 7 i ligjit nr.8227, datë 30.07.1997 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.8215, datë 09.05.1997 "Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë", vjen në kundërshtim me nenet 3, 10 e 11 të Ligjit "Për dispozitat kryesore kushtetuese", prandaj duhet të shfuqizohet.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë. në bazë të nenit 24 e vijues të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" me shumicë votash.

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e nenit 7 të ligjit nr.8227, datë 30.7.1997 "Për disa ndryshime në ligjin nr.8215, datë 9.5.1997 "Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë" .

2. Pezullimin e zbatimit të nenit 7 të këtij ligji deri në botimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare .

3. Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi me botimin e tij në Fletoren Zyrtare .

Tiranë, më datë 13.11.1997

MENDIM PARALEL

Përveç shfuqizimit të nenit 7, Gjykata duhet të ishte shprehur edhe për disa dispozita tjera të ligjit që kanë të bëjnë me disponim të pasurisë ose me shkelje të parimeve rëndësishme kushtetuese.

Të tilla janë dispozitat e nenit 3 si dhe neni 6 germa "a" të ligjit, të cilat nuk lejojnë fillimin ose vazhdimin e proceseve nga gjykata ose prokuroria, pa mbaruar kontrolli dhe administrimi në subjektet e kontrolluara. Këto përcaktime të ligjit bien ndesh me parimin pavarësisë së gjykatave. Kur një çështje është duke u shqyrtuar nga gjykata, nuk ka të drejtë asnjë organ tjetër që ta marrë në shqyrtim.

I pabazuar është edhe formulimi në nenin 5 të ligjit sipas të cilit dhënia e një vendimi përfundimtar nga Gjykata e Apelit nuk përjashton të drejtën e Këshillit të Ministrave që kur vëren se plotësohen kushtet e këtij ligji, të nxjerrë një vendim tjetër për caktimin e administratorit. Një formulim i tillë lë shteg që ekzekutivi të marrë vendime për ato çështje për të cilat është shprehur gjykata.

Edhe neni 8 i ligjit ka pasaktësi. Shprehja e përdorur se administratori lajmëron personin përfitues dhe "i kërkon atij kthimin e kësaj pasurie në favor të administratorit" , i jep të drejtë këtij të fundit që të disponojë pasurinë e subjektit, njëlloj si të drejtat e parashikuara nga neni 7, prandaj kjo shprehje duhet të hiqet nga ligji.

Duke u nisur nga titulli i ligjit, i cili nuk ndryshon as me shtesat që i janë bërë dhe që shpreh qëllimin e tij për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë, del se ligji është plotësisht i nevojshëm dhe i plotë përsa i përket aspektit të kontrollit dhe vendosjes së administratorëve mbi bazën e përfundimeve të kontrollit, por ka cenuar parimet kushtetuese në aspektet që përmenda më lart.

Tiranë, më 13.11.1997

ARSYETIM PARALEL

Ndonëse jemi bashkuar me shumicën e anëtarëve të Gjykatës në dhënien e vendimit për shfuqizimin e nenit 7 të ligjit nr.8227, datë 30.7.1997 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8215, datë 9.5.1997 "Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë", nuk jemi të një mendimi si përsa i përket mënyrës së motivimit të shfuqizimit të kësaj norme, ashtu edhe për shkak të kufizimit të shumicës në dhënien e vendimit vetëm për normën objekt kërkimi.

Për mënyrën e motivimit për shfuqizimin e nenit 7, kemi këto vërejtje :

Nuk janë çështje themelore vetëm të drejtat që i janë njohur administratorit mbi veprimtarinë dhe pasurinë e subjektit të kontrollit, pasi pjesa më e madhe e tyre edhe mund t'i njihen në kushte të përcaktuara pa u cenuar të drejtat themelore të njeriut, lidhur me pronësinë private. Kryesorja edhe në këtë normë ligjore është se administratori i subjektit të kontrollit, të gjitha të drejtat përfshi edhe ato të disponimit të pasurisë i ushtron jashtë çdo kontrolli gjyqësor dhe në mënyrë të pakushtëzuar me pëlqimin e kreditorëve apo të subjektit të kontrolluar. Nga përmbajtja e nenit 7, del se administratori i ushtron të drejtat e tij të administrimit dhe të disponimit të pasurisë jo duke u bazuar në kriteret të përcaktuara ligjore, por vetëm në bazë të vlerësimit të vet subjektiv, kur "ai e konsideron të nevojshme", apo "në kushtet që ai e konsideron të arsyeshme". Për më tepër, administratorit i është njohur mundësia edhe e mosrespektimit të mjeteve të sigurimit të ekzekutimit të detyrimit të subjektit të kontrollit ndaj personave të tretë.

Për çështjen e dytë lidhur me kufizimin e vendimit vetëm për normën objekt kërkimi, mospajtimi ynë me shumicën qendron në faktin se ligji nr. 8227, datë 30.7.1997, duhej të shfuqizohej në tërësi si antikushtetues, duke mbetur në fuqi ligji nr.8215, datë 9.5.1997.

Në ligjin objekt shqyrtimi është lejuar mundësia e caktimit dhe e veprimtarisë së administratorit ose administratorëve të subjektit të kontrollit, që në fillim së bashku me ekspertet e kontrollit ose edhe më vonë, por pa u kushtëzuar kjo me nxjerrjen e rezultatit të kontrollit nga ana e ekspertëve (nenet 3 paragrafi i dytë, 5 dhe 6). Këtë përfundim e vërteton edhe mënyra e veprimit në praktikë nga ana e Këshillit të Ministrave.

Kjo procedurë e parashikuar në ligj i njeh Këshillit të Ministrave të drejtën që si organ ekzekutiv, krejt në mënyrë të njëanshme të urdhërojë administrimin e detyrueshëm (dhunshëm) mbi pasurinë e një ose disa subjekteve private.

Gjithashtu, me dispozitat e ligjit, administratorëve u është njohur e drejta që të verë dorë edhe mbi pasurinë e personit të tretë, kur vërehet prej tyre se pasuria i ka kaluar atij (përfituesit) në mënyrë të parregullt apo në kundërshtim me ligjin (neni 8).

Të gjitha këto prerogativa, ashtu si ato të nenit 7, i përkasin ekskluzivisht gjykatës. Vetëm ky organ është veshur me të drejtën e vlerësimit nëse një veprim juridik për kalimn pronësie është i pavlefshëm për shkak të kundërligjshmërisë. Por duhet theksuar se as gjykata nuk e ka në kompetencë të shpallë pavlefshmërinë e veprimit juridik për "parregullsi", siç i njihet kjo në nenin 8 të ligjit, organeve administrative.

Duke qenë dispozitat e sipërme të lidhura e të kushtëzuara nga njëra-tjetra dhe duke qenë nenet 7 e 8 vetëm konkretizim i mëtejshëm i dispozitave paraardhese, gjykata ishte e detyruar të vepronte "ultra petita", duke marrë në shqyrtim dhe duke i shfuqizuar si antikushtetuese.

Organi administrativ, pavarësisht nga niveli i tij, nuk mund të marrë asnjëherë prerogativat e pushtetit gjyqësor. Është organi gjyqësor ai që mund të vendosë për administrimin dhe disponimin e dhunshëm të pasurisë private në kushtet e parashikuara me ligj. Pikërisht njohja me ligj të këtyre kompetencave një organi administrativ, bie ndesh me garancitë kushtetuese për ndarjen e pushteteve dhe për mbrojtjen e pronës private nga çdo ndërhyrje e njëanshme (nenet 3 e 11 të ligjit "Për dispozitat kryesore kushtetuese".

Një shkelje tjetër kushtetuese e ligjit është se vendosja e administrimit të dhunshëm mbi veprimtarinë dhe pasurinë e subjektit të kontrollit, bëhet pa përfillur interesat dhe të drejtat e kreditorëve gjatë procesit të administrimit. Përfillimi i tyre nga çdo mundësi e pjesëmarrjes në këtë proces ua heq mundësinë për të mbrojtur të drejtat e tyre të njohura nëpërmjet një procesi të rregullt

ligjor, duke cenuar kështu garancitë kushtetuese të parashikuara nga nenet 25 e 38 të ligjit për "Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut".

Në normal kushtetuese dhe praktikën ligjore të vendeve të ndryshme, nuk është njohur një ndërhyrje e tillë e organit ekzekutiv mbi tagrat e pronësisë private, përveç shpronësimit në interes publik me shpërblim të plotë dhe në ndonjë shtet të veçantë edhe shtetëzimi i ndërmarrjeve dhe kalimi i tyre nga sektori privat në atë publik.

I vetmi kufizim kushtetues atje ku ndeshet, është se prona private nuk mund të ushtrohet në dëm të interesit të përgjithshëm. Shkelja e këtij parimi kufizues, sipas rastit, mund të përbëjë vepër penale ose vetëm veprimtari apo veprim juridik të kundërligjshëm. Por, në të gjitha rastet, kjo përcaktohet vetëm nëpërmjet gjykatës. Organi ekzekutiv mund të ndërhyjë drejtpërdrejt, kur janë kushtet e parashikuara në ligj, vetëm mbi veprimtarinë e personave juridikë shtetërore, duke vendosur mbi to një administrim të detyrueshëm (dhunshëm).

Tiranë, më 13.11.1997

ANËTARI
A. Karamuco

ANËTARI
H. Kopani

KRYETARI
R. Gjata

MENDIMI I PAKICËS

Jemi në kundërshtim me vendimin e shumicës për shpalljen në tërësi antikushtetues të nenit 7 të ligjit nr.8227, datë 30. 7.1997.

Ligji nr.8215, datë 9. 5.1997, i plotësuar me ligjin nr.8227, datë 30.7.1997, ka për qëllim vendosjen e kontrollit financiar të personave juridikë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë dhe marrjen në mbrojtje të interesave të masës së gjerë të depozituesve, kreditorë të personave juridikë në kontroll, pavarësisht se këta persona janë ose jo shoqëri rentiere, kur ekzistojnë presupostet se ushtrojnë veprimtari piramidale.

Për arritjen e objektivave të caktuara ishte e domosdoshme krijimi i një kuadri ligjor të përshtatshëm. Ligjvënësi, me anën e dy ligjeve të përmendura më lart -- duke lënë mënjanë të metat që paraqesin këto dy ligje jo vetëm nga ana e teknikës thjeshtë ligjore -- , i ka dhënë Këshillit të Ministrave të drejtën të caktojë një ose më shumë kontabël të pavarur për të kontrolluar gjendjen financiare të personave juridikë jobankarë, që marrin hua nga publiku i gjerë, të caktojë subjektet që i nënshtrohen këtij kontrolli dhe, kur plotësohet një ose më shumë nga ekstremet që parashikohen në nenin 6 të ligjit nr.8227, datë 30.7.1997 të caktojë administratorin, ndërsa në nenin 7 të këtij ligji caktohen kompetencat e administratorit.

Në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese ana e interesuar kërkon vetëm shfuqizimin e nenit 7, sepse vjen në kundërshtim me ligjin kushtetues dhe pikërisht me përmbajtjen e nenit 10 të ligjit "Për dispozitat kryesore kushtetuese".

Sipas nenit 10 të këtij ligji "ekonomia e vendit bazohet në shumëllojshmërinë e pronave, iniciativën e lirë të të gjitha subjekteve ekonomike dhe në rolin rregullues të shtetit".

Ky nen, në paragrafin e dytë, shton : Iniciativa ekonomike e personave juridikë dhe fizikë nuk mund të zhvillohet në kundërshtim me interesin shoqëror dhe nuk mund të cenojë sigurinë, lirinë dhe dinjitetin e njeriut".

Vetëm nëpërmjet një analize të shumëanshme dhe racionale të të dy paragrafëve të sipërme të nenit 10, duke patur parasysh nenin 27 të ligjit kushtetues nr.7692, datë 31. 3.1993 si dhe përmbajtjen e nenit objekt shqyrtimi nga kjo Gjykatë, mund të arrihet në konkluzione të drejta, në mënyrë që Gjykata Kushtetuese, duke patur si mbështetje kushtetutën, të mos vihet në pozicionin e kundërvënies me ligjvënësin.

Në radhë të parë e quajmë të nevojshme të theksojmë se shteti, i përfaqësuar kryesisht nga organi ligjvënës, nuk mund të jetë indiferent, nuk mund të mbajë qëndrimin e një spektatori pasiv ndaj problemeve me karakter të mprehtë social, si në rastin konkret : të qenit në lojë të interesave të një numuri të madh njerëzish.

Roli rregullues i shtetit, në këtë kontekst, si çdo rregull tjetër me vlerë konstitucionale - në këtë teren nuk pranohen përjashtime -- nuk ka karakter deklarativ. Në të kundërtën, ai ka karakter

konstitutiv, me përmbajtje dhe qëllim të caktuar.

Gjykata Kushtetuese, përballë një problemi aq të rëndësishëm (shfuqizimi i nenit 7 në fjalë), duhej të kishte parasysh, para së gjithash, karakterin e pronës dhe të drejta të prejardhura prej saj, si dhe karakterin e rolit rregullues të shtetit dhe hapësirën e shtrirjes së tij.

Prona, sipas doktrinës ose më mirë sipas tezës dominonjëse, përqafuar -- përkundrejt tezës tjetër, sipas së cilës prona është institucion natyral -- edhe nga jurisprudenca konstitucionale e shumë vendeve të përparuara (Gjermani, Itali, etj.), është një institucion thjeshtë social, i mbrojtur nga ligji konstitucional.

Nga koncepti i sipërm se prona është një institucion social del se përcaktimi i karakterit dhe i kufijve të saj, i përket ligjvënësit. Ligjvënësi ka të drejtë të vendosë rregulla për përdorimin e pronës, të parashikojë ndërhyrjen sa herë që ushtrimi i të drejtave që rrjedhin prej saj, u kundërvihen interesave të përgjithshme të shoqërisë dhe t'u verë kufizime këtyre të drejtave.

S'ka dyshim se kufizimet që vendosen nga organi ligjvënës kanë lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së pronarit dhe kurrësesi me një përjashtim të vetëm të parashikuar shprehimisht nga kushtetuta, me përjashtim të shpronësimit --ato nuk mund të prekin substancën e pronës.

Edhe liria në marrjen e iniciativave të ndryshme në fushën ekonomike -liri kjo e mbrojtur konstitucionalisht --i shtrohet kufizimeve nga ana e shtetit. Vetë ligji kushtetues nr.7491, datë 29.4.1991, në nenin 10, paragrafi i dytë, përcakton kriteret e vendosjes së kufizimeve : kur ajo zhvillohet në kundërshtim me interesin shoqëror ose kur cenohet siguria, liria dhe dinjteti i njeriut.

Kështu, si e drejta e pronës ashtu dhe iniciativa e lirë në ekonomi, të radhitura ndërmjet të drejtave dhe lirive themelore, nuk kanë karakter absolut dhe nuk janë të paprekshme.

E drejta e pronës mund të preket në esencën e saj në një rast të vetëm të parashikuar nga neni 27 i ligjit kushtetues nr.7692, datë 31.3.1993. "Askush --thuhet në këtë nen --nuk mund të shpronësohet (lexo të privohet nga e drejta mbi pronën e vet), përveçse për një interes publik dhe kundrejt një shpërblimi të plotë".

Sikundër nuk ka antinomi ndërmjet pronës dhe shpronësimit të saj për interes publik, nuk ka antinomi edhe ndërmjet pronës dhe iniciativës së lirë dhe vendosjes së kufizimeve për interesin e përgjithshëm, për mbrojtjen e interesave të një masë të madhe depozituesish në shoqëri piramidale.

Në Protokollin e Parisit datë 20. 3.1952 në nenin e parë thuhet : "Çdo person fizik ose moral ka të drejtën e respektimit të pasurisë së tij. Askujt nuk mund t'i mohohet prona veçse për dobi publike dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

"Dispozitat e sipërme nuk cenojnë të drejtën që kanë shtetet të nxjerrin ligjet që gjykojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pronës në pajtim me interesin e përgjithshëm".

Nga komentet që i bëhen paragrafit të dytë të nenit të sipërpërmendur, del se "shteti mund të kufizojë ushtrimin e së drejtës së pronës. Shteti mund të privojë një person nga prona e tij për shkak dobie publike në kushtet e parashikuara me ligj. Gjithashtu, shteti ka të drejtë të miratojë ligjet që i quan të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pronës në pajtim me interesin e përgjithshëm".

Përmbajtja e nenit 7 që kërkohet të shpallet antikushtetues, nuk u përgjigjet kërkesave dhe parimeve të parashtruara më sipër. Me të drejtë, nga njëra anë, parashikohet në këtë dispozitë se drejtimi i veprimtarisë dhe i pronësisë së subjekteve të kontrollit apo të personave të lidhur me ta, i kalon administratorit, duke patur ky i fundit të gjitha të drejtat e personelit administrativ dhe, nga ana tjetër, i njihet administratorit e drejta që të shesë e të disponojë në mënyrë ligjore pjesë (lexo tërë pasurinë) të pasurisë të subjekteve të kontrollit. Kjo e drejtë e njohur administratorit nuk prek, thënë me metaforë, shtresat sipërfaqësore të pronës, por substancën e saj, ajo denaturon krejt të drejtën e pronës.

Për këto arsye jemi të mendimit që të shpallej pjesërisht antikushtetues neni 7 i ligjit nr.8227, datë 30. 7.1997 dhe në ato pjesë që i njihet administratorit e drejta të shesë dhe të disponojë pasurinë e subjekteve të kontrollit apo të personave të lidhur me ta.

Tiranë, më 13.11.1997

ANËTARI
H.Dakli

ANËTARI
M. Konomi

MENDIMI I PAKICËS

Jam kundër pikëpamjes së pranuar nga shumica e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese në vendimin e saj të datës 13.11.1997.

Për mendimin tim, kërkesa e Kompanisë "Vefa, Holding" për shfuqizimin e nenit 7 të ligjit nr .8227, datë 30.7.1997 "Për disa shtesa e ndryshime të ligjit nr .8215, datë 9. 5.1997 "Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë", duhej refuzuar.

Pretendimet e kërkuarit se kjo dispozitë e ligjit është antikushtetuese mbështeten në koncepte tashmë të kapërcyera. Ndryshe nga sa ai ka parashtruar, prona private dhe iniciativa e lirë ekonomike private e kanë humbur me kohë karakterin e tyre absolut dhe të pakufizuar . ligji ynë kushtetues dhe i gjithë legjislati tjetër në fuqi nuk i konsideron më të shenjta e të paprekshme. Ashtu si llojet e tjera të pronësive që ekzistojnë në ekonominë tonë kombëtare edhe ato kanë marrë një fizionomi të re dhe janë të orientuara të kryejnë në radhë të parë funksionin e tyre social.

Ky konkluzion del i qartë nga përmbajtja e paragrafit të dytë të nenit 10 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", dhe ajo e nenit 149 të Kodit Civil. Në të dyja këto dispozita është parashikuar se : Iniciativa ekonomike e personave juridikë dhe fizikë nuk mund të ushtrohet në kundërshtim me interesin shoqëror dhe nuk duhet të cenojë sigurinë, lirinë dhe dinjitetin e njeriut, se gëzimi dhe disponimi i sendeve që janë objekt i pronësive mund të bëhen lirisht, por këto të drejta duhet të ushtrohen brenda kufijve të caktuar nga ligji.

Rrjedhimisht duhet pranuar se kur nga ana e pronarit kalohen këto caqe, shteti ka jo vetëm të drejtë, por edhe detyrë të ndërhyjë, duke u vënë në rolin e rregullatorit dhe kjo detyrë i ngarkohet atij nga ligji kushtetues (neni 101).

Sigurisht roli i tij në përmbushjen e kësaj detyre është një rol aktiv. Ai nuk mund të qëndrojë indiferent kur nga veprime të paligjshme të pronarit vihet në rrezik interesi i shoqërisë ose cenohen vlera të tjera kushtetuese që janë të lidhura me personalitetin e njeriut. Format dhe mjetet e reagimit të tij në këto raste janë të ndryshme. E tillë është edhe ajo e parashikuar në ligjin e kundërshtuar nga kërkuari.

Ky ligj ka një natyrë kryesisht administrative sepse sfera e zbatimit të tij nga ana e gjykatës është më e kufizuar se ajo e administratës shtetërore. Megjithatë, kjo veçori e tij nuk do të thotë se ai është antikushtetues. Duke përfshirë këtu edhe nenin 7 të shfuqizuar nga gjykata.

Pikëpamja e shumicës se kjo dispozitë nuk pajtohet me kushtetuten për shkak se për ligj ndërhyrjen e ekzekutivit në pushtetin gjyqësor dhe lejon cenimin e pronës si e drejtë themelore e njeriut , pa u zhvilluar më parë një proces i rregullt ligjor, mua më duket se nuk qëndron.

Në rastin konkret kemi të bëjmë me normën e një ligji të posaçëm, i cili ka specifikat dhe përjashtimet e veta. Pikërisht kjo karakteristikë bën që vlera e tij të mos matet, duke e krahasuar atë me ligjet e tjera të zakonshme që parashikojnë rregulla të përgjithshme. Në fushën e marrëdhënieve juridike, për rregullimin e të cilave është nxjerrë, si edhe ndaj personave që u adresohet, ai ka fuqi absolute qofshin këto edhe ligje të tjera specifike siç është ligji "Për Falimentimet".

Parlamenti Shqiptar ,duke miratuar këtë ligj ka synuar në radhë të parë, që krahas kontrollit të transparencës së veprimtarisë së një kategorie të caktuar personash juridike, të realizojë edhe qëllime të tjera.

Për këtë shkak, këtë detyrë kontrolli ai ia ka ngarkuar kryesisht Qeverisë, sepse kjo është prerrogativë e natyrshme e saj .

Nga ana tjetër, në situatën e rëndë të krijuar për shkak të kësaj veprimtarie të mirëfilltë bankare që kanë zhvilluar, si kërkuari ashtu edhe sipërmarrje të tjera private, të cilat kanë grumbulluar në formë depozitash të holla nga publiku i gjerë, pa qenë ata të pajisur , sipas rregullit me licencën e Bankës së Shqipërisë dhe pa e pasë të pasqyruar këtë lloj aktiviteti në aktin e tyre të themelimit, ligjvënës ka parashikuar që epiqendra e këtij kontrolli të jetë mbrojtja e interesave të masës së gjerë të kreditorëve.

Për arritjen e këtyre qëllimeve ai në këtë ligj ka parashikuar një procedurë të veçantë, krejt të ndryshme nga procedura e falimentimit ose ajo që zbatohet për ekzekutimin e detyrueshëm, nga ana e përmbartuesit gjyqësor. Arsyeja është e qartë. Ai nuk ka dashur të zbatojë ligjin e egër të falimentimit, vetëm e vetëm për të mos krijuar probleme të reja sociale. Falimentimi është i lidhur me mbylljen e aktivitetit ekonomik të këtyre firmave private dhe do të cojë patjetër në humbjen e vendeve të punës për një numër jo të vogël punonjësish si edhe në lindjen e vështirësive të tjera për furnizimin e popullit

me mallra ose shërbime.

Prandaj për zgjidhjen e këtyre detyrave komplekse që i dalin Qeverisë, është e domosdoshme që përfaqësuesit e saj që dërgohen pranë këtyre subjekteve si administratorë, të jenë aty të pranishëm si para, gjatë ashtu dhe pas përfundimit të kontrollit të transparencës. Ata nuk duhet të jenë formale, por të ushtrojnë të gjitha kompetencat që u njeh neni 7 i ligjit objekt shqyrtimi. Sipërmarrësit e këtyre firmave duhet të spostohen jo vetëm nga e drejta e administrimit por edhe nga e drejta e disponimit të pasurisë. Gjithëçka që ka lidhje me aktivitetin ekonomik të këtyre firmave duhet të vihet nën kontrollin dhe drejtimin e administratorit.

Në bazë të nenit 7 të ligjit të sipërmendur, ky është përfaqësues i shtetit, ortak në këto sipërmarrje private vetëm në kryerjen e detyrave, por jo ortak edhe në ndarjen e fitimeve. Ndryshe, po të lihet pasuria në dorë të pronarit dhe të mos spostohet ky nga e drejta e administrimit dhe e disponimit të saj, ekziston rreziku që ai ta pakësojë ose ta fshehë atë, të bejë transferta, në drejtime të paditura ose të shlyejë pa kriter detyrimet, duke renduar pozitën e kreditorëve dhe duke cenuar në këtë mënyrë, parimin e barazisë midis tyre, në realizimin e kredive.

Nga ana tjetër, po të jetë ai në krye të punëve dhe jo administratori, ky i fundit nuk do të ketë mundësi të zbatojë planin e masave për shëndoshjen e gjendjes me qëllim që të shkohet drejt zgjidhjes ose zbutjes së problemeve sociale që kanë lindur si rezultat i veprimtarisë së paligjshme të këtyre sipërmarrjeve..

Tiranë, më 13.11.1997

Anëtar
Zija Vuci